



**PASTË RAHMET HEROI
MË I MADH I KRYEQENDRËS
SË VERIUT, HASAN RIZA PASHA!**



**ILUZIONI SE MENDJA
UDHËHEQ BOTËN**



**AKIDEJA NJERËZORE
NGA FAZAT PRIMITIVE
TE TEUHIDI**

UDHA ISLAME

Viti 24 - Nr. 1 (275), Janar, 2026

www.myftinia-shkoder.org

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative



MYFTINIASHKODER1990

NDODHIA E ISRASË DHE MIRAXHIT, MREKULLIA E RIMËKËMBJES SË PËRJETSHME!

KUPOLA E SHKËMBIT – KUDSI SHERIFË

MYFTIU I SHKODRËS: “TË NA SHËRBEJNË
TRE MUAJT E MIRË PËR RRRITJEN TONË
NË BESIM!”

DR. ZEKERIJA BAJRAMI, KËSHILLA DHE
MESAZHE TË URTA NË PRAG TË RAMAZANIT

MYFTIU I SHKODRËS VIZITOI
BASHKËSINË ISLAME SHQIPTARE
NË DANIMARKË

“KËSHILLI I PAJTIMTARËVE”,
PROJEKTI MË I RI I MYFTINISË SHKODËR

40 UMREXHI SHKODRANË
NISEN DREJT VENDEVE TË SHENJTA

“BESONI TEK E MIRA QË BËNI!”,
MESAZHE ME VLERË
NGA H. TAHIR ZENELHASANI



Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

PASTË RAHMET HEROI MË I MADH I KRYEQENDRËS SË VERIUT, HASAN RIZA PASHA!

“Hasan Riza Pasha me shkencën e vet strategjike ka lënë gjurmë të pashlyeshme në historinë ushtarake si mbrojtës i Shkodrës në rrethimin historik të saj që, ndonëse i huej, tue krye në kuptimin ma të plotë detyrën e tij, kjo një ndër shkaqet jo ma të mramet që Shkodra muejt me qenë pjesë e pandame e nanës Shqipni. Me vullnetin e pathyeshëm të Hasan Riza Pashës u ndalue turri i ushtrive të besëlidhuna balkanike...”

Allahu i Madhëruar të pastë në mëshirën e Tij, Komandanti legjendar i Shkodrës, Mbrojtësi i saj, Heroi më i madh i kryeqendrës së Veriut, Hasan Riza Pasha!

Sa me madhështi lexohen sot, fjalët e Hortense von Zambaur, gruas së konsullit austriak në Shkodër, asokohe, kur shkruan në Ditarin e saj: “Heroi i rrethimit të Shkodrës është i veshur me uniformë ushtarake, me një qëndrim si Napoleoni. Sido që të përfundojë kjo luftë, emri i tij do të shënohet përjetë në analet e historisë!” – (Ditari i cit., f. 18-44).

Hamdi Bushati, duke iu referuar revistës “Cirka”, 1928, teksa përshkruan Komandantin, citon: “Hasan Riza Pasha me shkencën e vet strategjike ka lënë gjurmë të pashlyeshme në historinë ushtarake si mbrojtës i Shkodrës në rrethimin historik të saj që, ndonëse i huej, tue krye në kuptimin ma të plotë detyrën e tij, kjo një ndër shkaqet jo ma

të mramet që Shkodra muejt me qenë pjesë e pandame e nanës Shqipni. Me vullnetin e pathyeshëm të Hasan Riza Pashës u ndalue turri i ushtrive të besëlidhuna balkanike...” – (Hamdi Bushati, “Shkodra dhe motet”, bot. i 2-të, Shkodër, 2005, v. 1, f. 365).

Dhe rikthehem te Ditari i zonjës austriake në Shkodër: “19 tetor 1912. Në ndërtesën e Bashkisë u ngrit flamuri i gjelbër i Profetit. Lajmëtari publik (tellalli) bën thirrje që të luftojnë e të vdesin për Atdheun. Myslimanët janë të mbushur me entuziazëm dhe të shumtë janë ata që vrapojnë me armë në duar nëpër trashe.

25 nëntor 1912. Një shpallje e vendosur në mur, e nënshkruar nga Hasan Rizaja dhe Esat Pasha, njofton banorët e Shkodrës se ai që shprehet për dorëzimin e qytetit, do të varet!

28 nëntor 1912. (Dita e pavarësismit. -M.S-). Turqit e tregojnë veten edhe një herë si mbrojtës shumë të fortë.”


Dhe emri i Komandantit legjendar,



mbetet edhe sot, një Diell vezullues mbi Shkodër, feksimin e të cilit s’e mbulon dot as krrakëllima e korbave të mesjetës, as hutia e “njeriut të ri”, që dorë për dore, shtiren si ndërtues të së resë në realitetet e këtij nënqielli!

Pastë rahmet Heroi ynë i Madh!

Në gjunjë, mbi tokën e lirë të Shkodrës, në lutje për heronjtë e mëdhenj të saj, më 30 janar 2026



“NGRIHUNI NË KËMBË PËR KËTË EMËR!”

Ditën e xhuma, më 30 janar 2026, nëpërmjet minberit të xhamisë së Parrucës, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, iu drejtua besimtarëve me një mesazh në përkujtim të rënies së Komandantit legjendar, Mbrojtësit të Shkodrës dhe Valiut të saj, Hasan Riza Pasha, më 30 janar 1913, në ditët e vështira të rrethimit të Shkodrës.

Gjatë hytbes së kësaj xhumaje, Myftiu i Shkodrës vuri theksin tek pozita e lartë e komandantit Hasan Riza Pasha, ku ndër të tjera theksoi aftësitë e mëdha të këtij Heroi të madh të kombit tonë, veçori me të cilat spikati si një udhëheqës me peshë, që siç thonë edhe shënimet e shtypit të kohës: “Hasan Riza Pasha me shkencën e vet strategjike ka lënë gjurmë të pashlyeshme në historinë ushtarake si mbrojtës i Shkodrës në rrethimin historik të saj që, ndonëse i huej, tue krye në kuptimin ma të plotë detyrën e tij, kjo një ndër shkaqet jo ma të mramet që Shkodra muejt me qenë pjesë e pandame e nanës Shqipni. Me vullnetin e pathyeshëm të Hasan Riza Pashës u ndalue turri i ushtrive të besëlidhuna balkanike...” – (Hamdi Bushati, “Shkodra dhe motet”, bot. i 2-të, Shkodër, 2005, v. 1, f. 365).

Gjatë hytbes së kësaj xhumaje, Myftiu i Shkodrës iu referua ditarit të zonjës Hortense von Zambaur, bashkëshortja e konsullit austriak në Shkodër asokohe, e cila ka mbajtur shënim detaje të ndryshme nga realiteti i Shkodrës në ato muaj të vështirë të rrethimit të vendit tonë, si dhe pozitën e lartë të Mbrojtësit të Shkodrës, Hasan Riza Pasha.

Ndër të tjera, Myftiu theksoi se: “Në shënimet e zonjës Hortense von Zambaur lexojmë edhe sa vijon: ‘18 tetor 1912. Mijëra shkodranë mysli-manë kanë rrokur armët dhe janë betuar që të vdesin për Atdheun... 19 tetor 1912. Në ndërtesën e Bashkisë u ngrit flamuri i gjelbër i Profetit. Lajmëtari publik (tellalli) bën thirrje që të luftojnë e të vdesin për Atdheun. Myslimanët janë të mbushur me entuziazëm dhe të shumtë janë ata që vrapojnë me armë në duar nëpër trashe. 25 nëntor 1912. Një shpallje e vendosur në mur, e nënshkruar nga Hasan Rizaja dhe Esat Pasha, njofton banorët e Shkodrës se

ai që shprehet për dorëzimin e qytetit, do të varet! ... 6 janar 1913. Sonte, në mbrëmje, e ndezëm përsëri pemën e krishtlindjeve. Hasan Rizaja, nëpërmjet kolonel Fahri Beut, i ka dërguar burrit tim një fotografi. Heroi i rrethimit të Shkodrës është i veshur me uniformë ushtarake, me një qëndrim si Napoleoni. Sido që të përfundojë kjo luftë, emri i tij do të shënohet përjetë në analet e historisë!’ ...” – theksoi ndër të tjera Myftiu Sytari.

Gjatë hytbes së kësaj xhumaje, Myftiu përmendi poashtu edhe vargjet e marshit që Hasan Riza Pasha kërkoi nga poeti At Gjergj Fishta, ku ndër të tjera lexojmë:

Prej kah lenë e merr hana

Mu çue shekulli kundra nesh

Djelm kreshnikë na bani nana

Vetëm na iu dalim ndesh.

Të parët tonë burra çelikut

Bota mbarë sot i nderon

Ata i binin ndesh armikut

Si rrufeja kur veton.

Në ballë të ushtrisë u ngreh bajraku

Luftë buria që po thërret,

Bini djelm ku derdhet gjaku,

Për liri e për Mbret.

Kush të jetë djal në ushtri të Sulltanit

Kush të jetë djal që deken ban

Të dalin sot ai në fushë të mejdanit

Me dhanë jetën për vatan

Asht ollsun ushtria Osmane

Nene Sanxhak rreshtue tabor

Marre të parve kurr s’iu çon

Se përpara bijnë gjallë në vorr.

Poashtu solli në vëmendje edhe argumente të tjera plot vlerë, që tërheqin vëmendjen për respektin dhe nderim që duhet të kemi të gjithë për personalitetin e lartë të këtij Heroi të madh të kombit tonë.

Në fund të ligjërimit të tij, Myftiu Sytari kërkoi që në përfundim të namazit të xhumasë së sotme lutja e kësaj dite t’i kushtohet shpirtit të Komandant Hasan Riza Pashës dhe dëshmorëve të Shkodrës që dhanë jetën, që të gjithë ne dhe kryeqendra e veriut të ngelej pjesë e hartës të Shqipërisë sonë të shtrenjtë.



H. VEHBI S. GAVOÇI
(1923 - 2013)

“

M e e ruajt Medhhebin Hanefi, me mësim e zbatim (tek ne) dhe me ditë se është Medhhebi i shërbyer nga qindra e mijëra dijetarë në Kur'an, Hadith, Besim, etj.

Siç dihet, Ebu Hanifja ka qenë i pari që ka shkruar në Besim dhe ka rregulluar mësimet e Fikhut që merret me ibadet e lidhje jetese me të tjerët. Ata që kanë ardhur pas tij, deri dijetarët e hadithit, si Buhariu, kanë vazhduar rregullin e tij.

Mos i jepni vëmendje disa fjalëve të reja që fliten këndeje e andej, si: selefi, dijetarë të hadithit dhe të disa njerëzve që ndoshta shiten se dinë më mirë se të parët e medhhebeve e dijetarët e medhhebeve të ndryshëm. Ne duhet të qëndrojmë në medhhebin tonë, mirëpo duhet të mësojmë mirë e më mirë, me fakte e me dogma!

Të punojmë për t'i shtuar mësimet fetare në jetën tonë me lëndët e ndryshme të saj, të lidhura nga dija, mirë e më mirë, e t'i nderojmë hoxhallarët se ata në të vërtetë e kanë ruajtur fenë gjatë periudhës së regjimit komunist në vendin tonë, e kur erdhi liria, u ngritën të na mësojnë fenë.

(Nga libri: Syneti e bidati)





Naim Driaj

Imam - Xhamia Parrucë

I. DISA VEÇORI TË MUAJIT SHABAN

1. Pejgamberi (a.s) agjëronte shumë në muajin Shaban. Agjërimi ka qenë një praktikë e vazhdueshme në jetën e tij, por ai e shtonte më shumë këtë ibadet kur afrohej muaji i Ramazanit. Aishja (r. anha) thotë: “Nuk e kam parë Pejgamberin (a.s) të agjërojë një muaj të tërë përveç Ramazanit, ndërsa më shpesh e kam parë duke agjëruar në muajin Shaban”.¹

Një veçori dalluese e këtij muaji ishte angazhimi i Pejgamberit (a.s) për agjërim, duke e shtuar këtë ibadet si një përgatitje për muajin e shenjtë të Ramazanit.

2. Ajo që e bën të veçantë këtë muaj është se ai përfaqëson fazën përfundimtare dhe mbledhëse të çdo përpjekjeje, për t’u përgatitur sa më mirë, për një Ramazan sa më cilësor.

3. Veçantia e këtij muaji është edhe një ngjarje e madhe dhe shumë e rëndësishme: raportimi vjetor i veprave për secilin prej nesh.

Usume bin Zejd (r.a) transmeton e thotë: “I thashë Profetit: O i Dërguar i Allahut, nuk të kam parë të agjërosh ndonjë muaj tjetër (përveç Ramazanit)

ÇFARË E BËN TË VEÇANTË MUAJIN SHABAN?

më shumë se sa muajin Shaban? Ai tha: Ai është një muaj mes Rexhebit dhe Ramazanit. Njerëzit tregohen të pakujdesshëm në këtë muaj, megjithëse ai është muaji në të cilin ngriten veprat tek Allahu (xh.sh). Prandaj unë kam dëshirë që veprat e mia të ngriten (paraqiten) te Zoti, ndërsa unë jam agjërueshëm.”²

Për një njeri që e di se çfarë do të thotë dalja para Allahut dhe llogaridhënia, kjo ngjarje është shumë e rëndësishme për të.

II. ÇFARË DUHET TË BËJMË NË KËTË MUAJ?

Ka shumë gjëra që duhet t’i bëjmë në këtë muaj, por do të përmendim disa prej tyre që duhet të fillojmë t’i realizojmë (veprojmë) nga sot.

- Të pendohemi sinqerisht tek Allahu (mos ta shtyjmë pendimin për më vonë).

- Të shtojmë agjërimin (të paktën të hënën dhe të enjten).

- Të shtojmë përmendjen e Zotit (dhikrin).

- Të përmirësojmë namazin tonë.

- Të tregohemi sa më bujarë gjatë këtij muaji. Pejgamberi (a.s) ishte shumë bujar, por ai ishte edhe më bujar, në muajin e Ramazanit.”³ Por, për të qenë bujar në këtë muaj të shenjtë, duhet ta trajtojmë veten tonë që tani.

Të gjitha këto janë udhëzime të rëndësishme dhe mirësi të Zotit, i Cili na mundëson, që me iniciativa modeste, të fitojmë shumë shpërblim. Prandaj, shfrytëzoje këtë muaj, pasi nuk dihet se kush do ta arrijë Ramazanin. Ai që e shfrytëzon siç duhet këtë muaj dhe përgatitet për të, edhe nëse nuk e arrin atë, do të shpërblehet, për faktin se ka

qenë i sinqertë dhe ka treguar interesim për ta pritur atë siç duhet.

III. ÇFARË PËRFITOJMË NGA KY MUAJ?

1. Ky muaj na mëson që të respektojmë dhe të madhërojmë gjithçka që Allahu dhe Pejgamberi i Tij e kanë respektuar dhe vlerësuar. Çdo gjë që Allahu dhe Pejgamberi i Tij e ka vlerësuar edhe ne duhet ta vlerësojmë dhe ta respektojmë.

2. Kujdesi për muajin Shaban është një tregues i sinqeritetit dhe vërtetësisë sonë për Ramazanin që po vjen. Me punën dhe zellin tonë në këtë muaj, dëshmojmë tek Allahu sinqeritetin tonë, duke treguar se jemi shumë të interesuar për të pritur Ramazanin që po vjen.

3. Ky muaj aktivizon te njeriu ndjenjën e vetëllogarisë. Për të dalë faqebardhë para Zotit, duhet që ta llogarisim veten herë pas here! Siç ka thënë Umeri (r.a): “Llogariteni veten tuaj para se të merreni në llogari.”⁴

Allahu (xh.sh) thotë: “O ju që keni besuar! Kini frikë Allahun dhe çdo njeri le të shikojë se çfarë ka përgatitur për nesër!”⁵

Gjatë këtij muaji, mundësia është ideale që të realizojmë të gjitha ato që përmendëm më lart, në mënyrën më të mirë, siç janë vetëllogaritja, pendimi, përmirësimi dhe përgatitja për atë që na pret. Prandaj, është shumë e rëndësishme të vetëdijësohemi dhe të mos e kalojmë këtë muaj si çdo muaj tjetër, por ta shfrytëzojmë për të përmirësuar vetveten dhe për të thelluar lidhjen tonë me Allahun e Madhëruar.

2. Transmeton Imam Ahmedi dhe Nesaiu.

3. Transmeton Buhariu dhe Muslimi.

4. Hiljetu el-Evlja, 1/52.

5. Kur’ani, El-Hashr: 18.



1. Transmeton Buhariu dhe Muslimi.

PËR ZEMËRTHYERIT!

ED’HEM SHERKAVI

“Dhe, e luti Zotin e tij: Jam i mposhtur, prandaj më triumfo!” – (Kur’ani, El-Kamer: 10)

Dua e Nuhit (a.s), e cila e përmblyti tokën për hatër të saj!

Prej gjërave më të bukura, që kam lexuar nga Ibn Utthejmini, është fjala e tij:

Allahu i përgjigjet duasë së jobesimtarit që i është bërë zullum ndaj besimtarit zullumqar;

Jo nga dashuria për jobesimtarin dhe as nga urrejtja për besimtarin;

Por, nga dashuria për drejtësinë dhe urrejtjen për zullumin.

Nëse, kjo është gjendja e Allahut me jobesimtarin që i është bërë zullum; atëherë, si do të jetë gjendja e Tij (i lartmadhëruar qoftë) me besimtarin që i është bërë zullum?!

* * *

Më ka treguar babai i bashkëshortes time (Allahu e mëshiroftë) një ngjarje për të cilin ai ka qenë dëshmitar i saj.

Një pasanik dhe një njeri me ndikim

kishte një dyqan tregtie.

Pranë tij ishte një shtëpi e vogël e një vejushe të varfër.

Ai kërkonte ta blinte shtëpinë e saj me çmim krejt të lirë për të zgjeruar dyqanin e tij.

Ajo refuzonte t’ia shiste, se ku do të shkonte pastaj me fëmijët e saj?

Kështu që, filloi të trillonte gjithfarë historish ndaj saj dhe ta akuzonte në nderin e saj.

Një ditë prej ditësh, ajo i hyri në dyqanin dhe i tha:

A nuk gjete mënyrë tjetër për të marrë shtëpinë, përveç se të më akuzosh në nderin tim?!

‘O Zoti im, nëse ky është gënjeshtar dhe shpifës, dërgo mbi të një bombë dhe të mos mbesë prej tij më shumë se një kile mish!’

Ditët kaluan dhe dua iu pranua.

Vjehri im mu betua, se ai ka qenë prej atyre të cilëve ja kishin mbledhur copat e trupit!!

Përktheu nga gjuha arabe:

Lavdrim Hamja



MYFTIU I SHKODRËS: “TË NA SHËRBEJNË TRE MUAJT E MIRË PËR RRITJEN TONË NË BESIM!”

Nëpërmjet minberit të xhamisë së lagjes Dërgut, ditën e xhuma, më 2 janar 2026, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, iu drejtua besimtarëve të shumtë të pranishëm në xhami me një mesazh që ka të bëjë me vlerësimin e mirësisë së madhe të udhëzimit në Islam dhe dëshimit të madhështisë së besimit në jetën e përditshme.

Nëpërmjet argumenteve të shumta nga Kur’ani Famëlartë dhe porosinë e të Dërguarit të Allahut (a.s), Myftiu Sytari u ndal fillimisht tek mirësia e madhe e të shijuarit të besimit në Allahun e Madhëruar në jetën tonë të përditshme.

Myftiu theksoi se prania e besimit në zemrat e njerëzve është mbi të gjitha një përzgjedhje hyjnore dhe dëshmi e dashnisë së Allahut të Madhëruar për gjithsecilin prej nesh.

Më pas Myftiu kërkoi nga besimtarët që të shfrytëzohet periudha e begatë e Tre Muajve të Mirë për të përmirësuar cilësinë e adhurimit, për të kërkuar falje nga Zoti i gjithësisë për gabimet dhe gjynahet e shkuara, si dhe për të hapur një faqe të re në jetën e gjithsecilit prej nesh.

Ai vuri theksin tek prania e istigfarit (kërkimit falje), në jetën e të dërguarve të Allahut, si dhe lutjen e tyre për besimtarët deri në ditën e fundit.

Myftiu e mbylli hytbenin e tij të kësaj jave duke sjellë në vëmendjen e besimtarëve një ngjarje të mrekullueshme nga jeta Hz. Muhamedit (a.s) dhe lutjen e tij të madhe për Nanën tonë të dashur, Hz. Aishen (r.anha), si dhe për çdo besimtar deri në ditën e fundit.

Ai tha se i Dërguari i Allahut (a.s) ka kërkuar falje për besimtarët, pas çdo namazi, edhe si një shenjë e lidhjes së përhershme që besimtarët kanë me njëri-tjetrin dhe përkatësinë e patjetërsueshme të besimit dhe lidhjes me Hz. Muhamedin (a.s) deri në frymën e fundit.

Gjatë hytbes së kësaj xhumaje u dhanë porosi dhe këshilla për të rregulluar marrëdhëniet familjare, faqefisnore dhe ato shoqërore, si dhe distancimin nga çdo frymë dhe agjendë që punon pandërprerje kundër besimit dhe vlerave të shëndosha të tij, sidomos kundër përpjekjeve sistematike të politikave të gabuara kundër familjes në Shqipëri.

NDODHIA E ISRASË DHE MIRAXHIT, MREKULLIA E RIMËKËMBJES SË PËRJETSHME!

Në simbolikën e saj, ndodhia e Israsë dhe Miraxhit, detajet e së cilës janë të panumërta dhe gjithëpërfshirëse, nëpërmjet dëshimit të saj në dy suret e zbritura në këtë përshtetësi; sureja “El-Isra” dhe sureja “En-Nexhm”; dëshmon se “Muhamedi (a.s) është i dërguar i dy kibleve, imami i dy lindjeve dhe i dy perëndimeve, trashëgimtari i të dërguarve para tij, prijësi i brezave pas tij! Pasi, në personalitetin e Hz. Muhamedit (a.s), mbrëmjen e Israsë, u takua Meka me Kuds, Bejtul-Harami me Mesxhidi Aksanë. Aty, të dërguarit u falën pas tij, duke sinjalizuar kështu universalizmin e dërgesës së tij hyjnore, përjetësimin e imamatit të tij, humanizmin e mësimeve të tij dhe përshtatshmërinë e tyre me gjithë ndryshimet e vendit dhe kohës”.^[1]

Israja dhe Miraxhi erdhën si përforcim i Hz. Muhamedit (a.s) në rrugën e tij të mundimshme të Thirrjes, në edukimin e brezave me dritën e udhëzimit hyjnor dhe begatitë e fesë së Allahut; ISLAMIT!

Atë natë, zemra e tij u mbush pafundësisht me dritën e pashuar të mbështetjes hyjnore, tamam si atë ditë, kur melekët i hapën gjoksin dhe ia mbushën me nurin e besimit dhe dashninë e Zotit!

Atë natë, iu dhurua amaneti më i shtrenjtë dhe garancia e përjetshme e lidhjes së qiellit me tokën dhe anasjelltas; namazi i pesë kohëve ditore!

Atë natë, u vulos mirësia dhe u derdhën bekime pafund për Pejgamberin tonë dhe ymetin islam, deri në ditën e kiametit!

Atë natë, teksa kthehej me pesë namazet e ditës, si rrugë e pambyllur drejt kërkimit të mëshirës dhe Dritës së Zotit në jetën tonë, fjalët e Krijuesit, ishin ngulitur thellë në zemrën e tij (a.s), do ua thoshte më pas edhe sahabëve dhe mbarë botës: “O Muhamed, këto janë pesë namaze, për çdo ditë dhe natë. Secili namaz do të shumëzohet me dhjetë, pra pesëdhjetë namaze...”^[2]

Sa bukur e shkruan Hoxha i jonë,

Shejh Vehbi Sulejman Gavoçi, se ai burrë i madh, që “një vit më parë, fëmijët e Taifit, qenë rreshtuar në të dy anët e rrugës dhe me gurë në duar, qëllonin këmbët e tij (a.s), teksa largohej prej aty për në vendin e vet, sot, pas një viti, po i rreshtoheshin Pejgamberët (a.s), atje në Kuds, me dhjetra të dërguar, të cilët po e prisnin me gëzim dhe donin të faleshin pas tij...”^[3]

Teksa lexojmë në historinë e Ibn Hishamit, mbi mrekullinë e Israsë dhe Miraxhit, sipas transmetimit të Ibn Mes’udit (r.a), vëmendja përqendrohet edhe tek kthimi i Resulullahut (a.s.)



nga takimi i tij me Zotin e botëve, ku u obligua me faljen e 50 namazeve ditore.

Thotë Resulullahu (a.s): “Dhe u ktheva. Kur kalova pranë Musait, të birit të Imranit, miku juaj i dashur, më pyeti se sa namaze m’u obliguan. I thashë: “Pesëdhjetë namaze ditore.” (Musai) Tha: “Namazi është i rëndë dhe ymeti yt janë të dobët, prandaj kthehu tek Zoti yt dhe kërkoi lehtësim për vete dhe për ymetin tënd!”

U ktheva tek Zoti im dhe i kërkova lehtësim për vete dhe për ymetin tim. Më lehtësoi me dhjetë (namaze). U largova dhe kalova pranë Musait, i cili më tha të njëjtat fjalë dhe u ktheva sërish tek Zoti im. Më lehtësoi me dhjetë të tjera. Sërish u ktheva dhe më tha të

njëjtat fjalë. U ktheva tek Zoti im, që më lehtësoi edhe me dhjetë të tjera, deri sa përfundoi në pesë namaze. Pastaj u ktheva tek Musai, i cili më kërkoi sërish të kthehem tek Zoti im dhe të kërkoi lehtësim. I thashë: Jam kthyer disa herë tek Zoti im dhe më ka lehtësuar, sa më erdhi turp prej Tij. Nuk kthehem më!”^[4]

Këto pesë namaze, ndonëse u lehtësuan nga pesëdhjetë të tilla në origjinën e obligueshmërisë, por ato do ta kenë shpërblimin e dhjetëfishuar tek Allahu i Madhëruar, që tha: “O Muhamed, këto janë pesë namaze, për çdo ditë dhe natë. Secili namaz do të shumëzohet me dhjetë, pra pesëdhjetë namaze...”^[5]

Është një mrekulli hyjnore që na fton drejt forcimit në bindjen dhe besimin tonë, drejt optimizmit të pathyeshëm dhe forcimit të vullneteve për ta dëshmuar fetarizmin tonë në jetë, pa ndrojtje dhe plot dinjitet!

Israja dhe Miraxhi, mbeten dy stacione të mrekullueshme, nëpërmjet të cilëve zemra e muslimanit forcohet përballë sfidave dhe kompleteve bashkëkohore, duke u lartësuar në pozitën e të pathyeshmit, qëndrestarit dhe ndërtuesit të urave lidhëse ndërmjet realiteteve të jetuara dhe lartësive të vlerave të besimit dhe Njësimit të Krijuesit të gjithësisë, të Cilit i falemi pesë herë në ditë, si një besëlidhje që ripërtërihet për të na mbajtur përherë të gjallë e krenarë!

Imam Muhamed B. Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

[1] Transmetuar nga Imam Buhariu, nga Enes ibn Malik (r.a) dhe Malik ibn Sa’sa’ (r.a).

[2] Es-Sejîd Ebul-Hasen Ali El-Haseni En-Nedvi, “Es-siretun-nebevije”, botimi i 12-të, Damask, 2004, f. 218-219.

[3] Vehbi Sulejman Gavoçi, “Muhammedi alejhisselam – Jeta dhe vepra”, LOGOS-A, Shkup, 2011, f. 117.

[4] Ibn Hisham, “Es-siretun-nebevije”, botimi i 4-t, Beirut, 1999, vëll. II, f. 37-38.

[5] Transmetuar nga Imam Buhariu, nga Enes ibn Malik (r.a) dhe Malik ibn Sa’sa’ (r.a).

NGJARJA E MADHE E ISRASË DHE MIRAXHIT

(15 janar 2026 – 27 Rexheb 1447)

Mrekullia e Israsë dhe Miraxhit, apo mrekullia e udhëtimit tokësor (Isra) dhe atij qiellor (Miraxh) edhe sot pas 15 shekujsh mbetet një ngjarje shumë e rëndësishme, me mësimet dhe refleksionet që na sjell, si në aspektin historik dhe fetar, por edhe në atë shkencor.

Mrekullia e Israsë dhe Miraxhit është e përbërë nga dy pjesë. Pjesa e parë, e cila përbëhet nga shpejtësia e jashtëzakonshme me të cilën Pejgamberi (a.s) bëri udhëtimin tokësor (Isra) nga Qabeja në Mekë për në xhaminë Aksa në Kuds, Sherifë. Pastaj, pjesa e dytë e mrekullisë, e udhëtimit hapësinor (Miraxh) nga toka, xhamia Aksa, për në qiell, që sado të mund të përparojë shkenca dhe teknologjia, nuk mund t’i përcaktojë se sa të mëdha ishin këto shpejtësi dhe as nuk do të arrijë ndonjëherë të njohë diçka rreth kësaj force, shpejtësie dhe mënyrës se si ndodhi ky udhëtim, vetëm aq sa na është treguar në Kur’anin Famëlartë.

Sipas transmetimeve, kjo ka ndodhur në vitin e 10-të të dërgesës së Pejgamberit (a.s), më 27 Rexheb.

Ky udhëtim është kryer me trup dhe me shpirt, në një pjesë të natës mes Qabes në Mekë për në xhaminë Aksa në Kuds, Sherifë. Udhëtim me trup dhe me shpirt, dhe jo vetëm me shpirt (në

gjumë, në ëndërr etj).

Kjo ngjarje e madhe dhe rëndësishme përmendet në dy sure të Kur’anit Famëlartë, në suren El-Isra dhe në suren En-Nexhm:

“Pa të meta është Lartmadhëria e Atij që robin e Vet e kaloi në një pjesë të natës prej Mesxhidi Haramit gjer në Mesxhidi Aksa, rrethinën e të cilës Ne e kemi bekuar, për t’ia treguar atij disa nga argumentet Tona. Vërtet, Ai është Dëgjuesi, Shikuesi.” – (Kur’ani, El-Isra: 1)

Bismilahi Rrahmnaï Rrahim: “Pasha yllin kur ai bie! Shoku juaj (Muhammedi) as nuk është njeri që ka humbur, e as që ka devijuar. Dhe ai nuk flet nga mendja e tij. Ai (Kur’ani) nuk është tjetër pos shpallje që i shpallet. Atë ia mësoi Ai, fuqiforti, (Xhibrili). Që ka mendje precize dhe që u përqendrua në formën e vet (reale). Dhe ai (Xhibrili) ishte në horizontin e lartë. Pastaj u lëshua dhe iu afrua. E ishte afër sa dy harqe (dy kutë) apo edhe më afër. Dhe i shpalli robit të Tij atë që ia shpalli. Zemra nuk mohoi atë që pa. A po i bëni polemikë atij për atë që ka parë? Atë (Xhibrilin) e ka parë edhe herën tjetër. (E ka parë) tek Sidretul Munteha. Që pranë saj është xhenneti Me’va (kopsht strehimi). Atëherë kur Sidrën e mbuloi çka e mbuloi. Shikimi (i Muhamedit) as nuk lakoi e as nuk tejkaloi. Ai (Muhammedi) vërtet, pa disa nga shenjat më të mëdha

të Zotit të vet!” – (Kur’ani, En-Nexhm: 1 – 18)

Në hadithin e saktë që transmeton ngjarjen-mrekulli të Israsë dhe Miraxhit, Pejgamberi (a.s) na tregon për mjetin e udhëtimit me të cilin përshkoi distancën dhe hapësirën qiellore, e kjo quhej Burak.

Çfarë ishte Buraku?

Pasi Pejgamberi (a.s) përfundoi udhëtimin e tij dhe u kthye në Mekke, ai u tregoi njerëzve për çfarë i kishte ndodhur gjatë një pjesë të natës. “Pastaj Xhebraili (a.s) më solli një kafshë të bardhë, e cila quhej Burak..., hidhte hapin ku i mbërrinte shikimi”. – (Transmeton Buhariu dhe Muslimi)

Po ashtu Pejgamberi (a.s) hyri në Mesxhidul-Aksa dhe fali dy rekate namaz.

Pastaj Xhibrili (a.s) i solli dy enë: njëren me verë dhe tjetrën me qumësht; dhe ai (a.s) zgjodhi qumështin. Xhibrili (a.s) i tha: “Ke zgjedhur natyrshmërinë (fitrën)!”

Pastaj ai (a.s) u ngrit në qiellin e parë, pastaj të dytin, pastaj të tretin... dhe kështu vazhdoi derisa arriti te Sidretul-Munteha, dhe Allahu i shpalli atij atë që i shpalli... dhe atë natë u bënë detyrim namazet.

Përgatiti:
Lavdrim Hamja





Arben Halluni, teolog

AKIDEJA NJERËZORE NGA FAZAT PRIMITIVE TE TEUHIDI

“...Dhe (kujto) kur Ibrahim i tha babait të tij, Azerit: “A i merr idhujt për zota? Unë po shoh se ti dhe populli yt jeni në një humbje të qartë.”

Dhe kështu Ne ia treguam Ibrahimit mbretërinë e qiejve dhe të tokës, që ai të bëhej prej atyre që kanë bindje të plotë...’ Unë e kam kthyer fytyrën time sinqerisht drejt Atij që krijoi qiejt dhe tokën dhe unë nuk jam prej idhujtarëve...!”

Besimi në shpirtat ka qenë ndër format më të përhapura të besimit të njeriu në fazat e hershme të udhëzimit fetar dhe të formimit të bindjes. Nuk ka asgjë të çuditshme që shpjegimi i udhëzimit të tij drejt idesë së “shpirtit” të lidhet me arsyen që e përmendën Spencer dhe Taylor: ëndrrat dhe përjetimi i gjendjeve të ngjashme me vdekjen. Në atë fazë, njeriu nuk kishte kapacitetin mendor për ta kuptuar shpirtin veçse përmes këtij perceptimi të errët, në mjegullën e injorancës dhe terrin e atyre kohëve.

Njeriu flinte dhe shihte veten duke ecur, duke vrapuar, duke ngrënë e duke pirë, duke u përballur me njerëz; më pas zgjohej dhe e gjente veten në të njëjtin vend, pa qenë larguar prej tij as edhe një hap. Atëherë i lindte bindja se diçka prej tij ishte larguar dhe ishte kthyer sërish: ishte shpirti që banonte në trupin e tij. Ai shihte të vdekurin në ëndërr, e shihte sikur lëvizte e vepronte, ndërkohë që

trupi i tij qëndronte i shtrirë pa jetë. Kështu u formua te ai bindja se vetja është shpirti, se shpirti është vetja dhe fryma. Edhe fjala greke “Psyche” ka kuptimin “frymë”, po ashtu edhe fjala “Spirit” në gjuhët evropiane moderne. Kjo është një tregues i qartë se origjina e kësaj ideje është shumë e hershme, që nga fëmijëria e mendjes njerëzore.

Ashtu siç sot ne e kuptojmë hijen që na shoqëron, dhe e dimë se ajo është vetëm pasqyrim i trupit tonë, ndërsa njeriu primitiv nuk i kuptonte hijet dhe as këto pamje, por i konsideronte si qenie reale që dilnin prej tij; ai besonte se trupi i tij kishte një kopje të gjallë që prekej nga magjia, nga shtrigat, dhe dëmtohej nga armiqtë, ashtu siç dëmtoheshin gjymtyrët e trupit të tij. Në këtë përfytyrim, shpirtat ndërthureshin me trupat e gjallë.

Ai nuk e dallonte botën e sendeve nga bota e hijeve dhe shpirtave. Nuk çuditej kur u fliste sendeve, ashtu siç

fëmija i drejtohet gjërave përreth tij me butësi apo frikë. Edhe sot, shumë njerëz të arsimit, në çaste zemërimi apo dhimbjeje, i flasin sendeve të pajeta sikur ato të kishin ndjenja dhe vetëdije.

Kështu, njeriu i parë arriti tek ideja e “shpirtit” nga disa përjetime të drejtpërdrejta. Ky udhëzim ishte një hap vendimtar në kulturën njerëzore, goftë në zhvillimin e mendjes, goftë në formimin e ndërgjegjes.

Nëse kjo ide do të zbatohet plotësisht, ajo do t’i hapte mendjes njerëzore një derë drejt botës përtej materies së dukshme dhe do ta sillte shkencën në një rrugë që do të përfundonte tek feja. Sepse vlerat e jetës fillojnë të marrin kuptim vetëm kur njeriu pranon ekzistencën e një dimensionit përtej asaj që preket dhe shihet.

Prej këtej lind ndarja mes shpirtit dhe trupit, mes mendjes dhe materies, mes lëvizjes dhe ngurtësisë, mes së mirës dhe së keqes, mes dritës dhe

FAZA E FUNDIT ËSHTË AJO E DALLIMIT TË QARTË MES KRIJUESIT DHE KRIJESËS, MES SIMBOLIT DHE REALITETIT, MES ADHURIMIT DHE NJOHJES. KY ËSHTË KALIMI NGA SHUMËSI I ZOTAVE DREJT NJËSHMËRISË, NGA HIJA DREJT DRITËS, NGA KËRKIMI DREJT BESIMIT TË QARTË...

errësirës, dhe mes kuptimeve abstrakte dhe objekteve të prekshme. Këtu fillon zgjerimi i horizontit njerëzor drejt asaj që është përtej botës shtazore.

Por njeriu nuk duhet të ndalet në këtë pikë; nuk duhet ta marrë këtë ide si qëllim në vetvete, as ta gjykojë saktësinë e saj vetëm nga ana logjike, por duhet ta vlerësojë drejtësinë e saj nga përputhja me realitetin dhe me shkaqet.

Këtu përmendet shembulli i babait që, para se të vdiste, u la fëmijëve amanet të mos e kërkonin pasurinë e tij në tokë. Ata gërmuan dhe nuk gjetën ar e argjend, por gjetën diçka më të vlefshme: punën dhe përpjekjen, të cilat u sollën pasuri brez pas brezi.

Edhe ideja e shpirtit ishte një hap që përmbante gabime, por ishte një gabim që hapi rrugën drejt së vërtetës në botën e mendjes dhe të ndërgjegjes.

Nga besimi në shpirta te adhurimi i diellit

Besimi në shpirt u ndërthur me çdo besim fetar pas fazave të tij fillestare. Edhe në adhurimin e idhujve, në mendjen e njerëzve u shfaq ideja e mbijetesës së shpirtave, sipas nivelit të zhvillimit të njohurive të tyre. Njeriu primitiv, nga padija mbi sekretet e riprodhimit, e përfytyronte shpirtin që kalonte nga një trup në tjetrin, madje edhe nga kafshët tek njerëzit.

Disa qytetërime besonin se shpirtat banonin në diell, dhe se trupat kishin prindër fizikë, ndërsa shpirtat kishin prejardhje hyjnore. Kjo shpjegon pse faraonët konsideroheshin bij të diellit, ndërkohë që trupat e tyre ishin njerëzore.

Adhurimi i diellit nuk ishte i pranishëm në fazat më të hershme të feve primitive, por u shfaq më vonë, kur u zhvillua mendimi shkencor dhe kulturor. Ai kërkonte një vizion kozmik më të gjerë, një kuptim të rregullit të

universit, të lëvizjes, jetës dhe vdekjes. Dielli u bë simbol i forcës, rregullit dhe burimit të jetës.

Por, ky ishte vetëm një hap më i avancuar drejt teuhidit. Sepse vëmendja u përqendrua tek një shkak i vetëm, por ende jo tek Shkaku Absolut. Këtë rrugë e përshkruan bukur Kur’ani në historinë e pejgamberit Ibrahim (a.s), i cili vështroi yllin, hënën dhe diellin, por në fund u kthye drejt Atij që krijoi qiejt dhe tokën...

Ja si e Kur’ani Famëlartë përmes sures El-En’am (6:74–79): “...Dhe (kujto) kur Ibrahim i tha babait të tij, Azerit: “A i merr idhujt për zota? Unë po shoh se ti dhe populli yt jeni në një humbje të qartë. Dhe kështu Ne ia treguam Ibrahimit mbretërinë e qiejve dhe të tokës, që ai të bëhej prej atyre që kanë bindje të plotë. Kur ra nata mbi të, ai pa një yll dhe tha: ‘Ky është Zoti im!’ Por kur ai perëndoi, tha: ‘Unë nuk i dua ata që perëndojnë!’ Kur pa hënën duke lindur, tha: ‘Ky është Zoti im!’ Por kur ajo perëndoi, tha: ‘Nëse Zoti im nuk më udhëzoi, me siguri do të jem prej popullit të humbur!’ Kur pa diellin duke lindur, tha: ‘Ky është Zoti im; ky është më i madhi!’ Por kur ai perëndoi, tha: ‘O populli im, unë jam i pastër nga ajo që ju i shoqëroni Allahut.’ Unë e kam kthyer fytyrën time sinqerisht drejt Atij që krijoi qiejt dhe tokën dhe unë nuk jam prej idhujtarëve...!”

Këto fjalë të Hz. Ibrahimit (a.s) nuk janë pohim real i besimit në yje, hënë apo diell, por argumentim logjik dhe pedagogjik për t’ua treguar popullit të tij se gjithçka që lind dhe perëndon nuk mund të jetë Zot. Kulmi i mesazhit ku shpallet teuhidi i pastër është ajeti 79: “Unë e kam kthyer fytyrën time sinqerisht drejt Atij që krijoi qiejt dhe tokën dhe unë nuk jam prej idhujtarëve!”

Teuhidi – kulmi i zhvillimit të besimit

Adhurimi i diellit u përhap në shumë qytetërime të lashta: në Egjipt, Babiloni, Persi dhe Indi.

Pyetja se cili prej tyre arriti i pari tek teuhidi mbetet çështje hamendjeje, jo bindjeje të prerë. Ajo që dihet është se teuhidi përfaqëson kulmin e pjekurisë fetare të njeriut.

Në përfundim, faza e fundit është ajo e dallimit të qartë mes krijuesit dhe krijesës, mes simbolit dhe realitetit, mes adhurimit dhe njohjes. Ky është kalimi nga shumësi i zotave drejt Njeshmërisë, nga hija drejt dritës, nga kërkimi drejt besimit të qartë...



Pejgamberi (a.s) ka thënë:

“

*Allahu
Ai vështroi
robërit e Tij
Natën e Gjysmës
së muajit Shaban
dhe i falë besimtarët,
i jep afat
jobesimtarëve dhe
i lë njerëzit e urrejtit
me urrejtit e tyre,
derisa të largohen
prej saj!*



(Transmeton Imam Ahmedi, Ibn Hibani, Ibn Ebi Shejbe dhe Tabarani)

UGANDA OSE REPUBLIKA E UGANDËS

Uganda, zyrtarisht Republika e Ugandës, është një vend në Afrikën Lindore, pa dalje në det, që ndodhet në rajonin e Liqeneve të Mëdha Afrikane dhe shtrihet gjithashtu brenda pellgut të Nilit. Vendi kufizohet me Sudanin e Jugut në veri, me Kenian në lindje, me Tanzaninë në jug, me Ruandën në jugperëndim, dhe me Republikën Demokratike të Kongos në perëndim, si dhe zotëron një pjesë të konsiderueshme të liqenit Viktoria, det i cili ndahet mes Ugandës, Kenias dhe Tanzanisë.

Uganda ka një sipërfaqe prej 241,038 km² dhe një popullsi prej 51,916,928 banorësh (nëntor, 2025, sipas worldometers.info).

Kryeqyteti dhe qyteti më i madh i vendit është **Kampala**.

GJEOGRAFIA

Pjesa më e madhe e Ugandës është e vendosur mbi një pllajë, një hapësirë e madhe që zbret butësisht nga rreth 1.500 metra në jug në afërsisht 900 metra në veri, e rrethuar nga male dhe lugina. Në perëndim malet Virunga, vargmalet Ruvenzori dhe lugina perëndimore e Riftit, përbëjnë një kufi natyror të saj. Malet vullkanike Virunga që arrijnë pikën më të lartë në malin Muhavura - me 4.125 metra lartësi - dhe që përfshijnë edhe malin Sabinio (3.645 m), gjenden aty ku takohen kufijtë e Ugandës, Republikës Demokratike të Kongos dhe Ruandës. Më në veri, vargmali Ruvenzori ngrihet në 5.109 metra në majën Margherita, pika më e lartë e Ugandës. Lartësitë e këtij vargmali shpesh fshehin nga retë, dhe majat e tij janë të mbuluara nga bora dhe akullnajat. Midis maleve Virunga dhe Ruvenzori shtrihen liqenet Edward dhe George. Pjesa tjetër e kufirit përbëhet nga lugina perëndimore e Riftit, në të cilën ndodhen liqeni Albert dhe lumi Nil-Albert.

Kufiri verilindor i pllajës përcaktohet nga një varg malesh vullkanike që përfshijnë malet Morungol, Moroto dhe Kadam, të cilat i tejkalojnë 2,750 metra lartësi. Mali më jugor - Mali Elgon - është gjithashtu më i larti i zinxhirit dhe arrin në 4,321 metra lartësi. Në jug dhe në perëndim të këtyre maleve është një zgjatim lindor i luginës së Riftit, si dhe liqeni Viktoria. Në veri, malet Imatong shënojnë kufirin e pllajës me Sudanin e Jugut, në një lartësi prej rreth 1,800 metrash.

Liqeni Viktoria i Ugandës (69,484 km²) gjendet në pjesën juglindore të vendit dhe është liqeni i dytë më i madh i ujërave të ëmbla në botë për nga madhësia, pas liqenit "Superior" në Amerikën e Veriut. Viktoria përbën gjithashtu një nga burimet e lumit Nil. Në vend ekzistojnë edhe pesë liqene të tjera të mëdha: Edward dhe George në jugperëndim, Albert në perëndim, Kyoga në Ugandën qendrore, dhe Bisina në lindje.

Përveç këtyre, në Uganda gjenden tetë lumenj të mëdhenj, që janë: Nili Viktoria në Ugandën qendrore; lumejtë Achwa, Okok dhe Pager në veri; Nili Albert në

KLIMA

Klima tropikale e Ugandës modifikohet nga lartësia e terrenit, kurse lokalisht, nga prania e liqeneve. Rrymat kryesore të ajrit janë verilindore dhe jugperëndimore. Për shkak të vendndodhjes ekuatoriale të Ugandës, ka pak ndryshim në deklinimin (ndryshimin e këndit) e diellit në mesditë, dhe gjatësia e ditës është pothuajse gjithmonë 12 orë. Të gjithë këta faktorë, së bashku me një mbulesë mjaft të qëndrueshme të reve, sigurojnë një klimë të qëndrueshme gjatë gjithë vitit.

Shumica e pjesëve të Ugandës marrin sasi të mjaftueshme të reshjeve. Sasia



veriperëndim; dhe Kafu, Katonga dhe Mpongo në perëndim. Me përjashtim të Nilit Viktoria dhe Albert, lumenjtë e tjerë janë të ngadaltë dhe shpesh moçalorë. Shumica e lumenjve janë sezonalë dhe rrjedhin vetëm gjatë sezonit të lagësht; madje edhe lumenjtë e paktë që janë të përherëshëm, i nënshtrohen ndryshimeve sezonale në shkallët e tyre të rrjedhjes.

Tokat e Ugandës janë në përgjithësi pjellore, dhe ato në rajonin e Liqenit Viktoria janë ndër më produktivet në botë.

vjetore varion nga më pak se 500 mm në verilindje deri në një maksimum prej 2,000 mm në ishujt Ssese të liqenit Viktoria. Në jug ekzistojnë dy stinë shiu (prill-maj, dhe tetor-nëntor) të ndara nga periudha të thata, megjithëse herë pas here ndodhin stuhitë tropikale. Në veri stina e reshjeve zgjat nga prilli në tetor, e ndjekur nga një stinë e thatë që zgjat nga nëntori në mars.

GJUHA

Në Uganda fliten të paktën 32 gjuhë, por më të përdorurat janë Anglishtja dhe Suahili (të dyja këto gjuhë zyrtare), si

dhe ajo Ganda. Anglishtja përdoret në arsim dhe qeveri, dhe njohja e saj është thelbësore për akses në poste të larta, prestigj dhe pushtet ekonomik e politik. Suahili u zgjodh si tjetër gjuhë zyrtare për integrimin rajonal, por njohja e saj në Uganda është më e ulët se në Tanzani, Kenia dhe pjesën lindore të Kongos, dhe është jo e popullarizuar nga disa që e lidhin këtë gjuhë me diktatorë dhe ushtri sunduese të mëparshme. Gjuhët indigjene përputhen me grupet etnike të vendit. Përveç anglishtes, frëngjishtes dhe suahilishtes, Radio Uganda transmeton në më shumë se 20 gjuhë indigjene, përfshirë ato Alur, Ganda, Lugbara, Masaba, Ruanda, Nkole, Nyole, Soga dhe Teso. Shumica e ugandasve kuptojnë disa gjuhë.

FEJA

Sipas Qeverisë së SHBA-së (<https://2021-2025.state.gov>), regjistrimi i popullsisë (viti 2014) raporton se muslimanët përbëjnë 14 % të popullsisë, por Këshilli i Lartë Musliman i Ugandës (UMSC) deklaroi se muslimanët janë afër 35 %. Shumica e muslimanëve janë sunitë, megjithëse thuhet se ka një numër të vogël muslimanësh shiitë, kryesisht në Kampala dhe në pjesën lindore të vendit, veçanërisht në distriktet Mayuge dhe Bugiri. Grupe të tjera fetare, të cilat së bashku përbëjnë më pak se 5 % të popullsisë përfshijnë Adventistët e Ditës së Shtatë, Baptistët, anëtarët e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, të krishterët ortodoksë, hindutë, hebrenjtë, baha'itë, ithtarët e besimeve indigjene dhe ata pa përkatësi fetare.

Pjesa tjetër janë popullsi e krishterë, ku grupi më i madh i krishterë është ai katolik romak, i ndjekur nga anglikanët dhe të krishterët pentekostalë.

EKONOMIA

Ekonomia e Ugandës është kryesisht bujqësore, sektor i cili punëson rreth katër të pestat e popullsisë. Klima e moderuar e vendit e favorizon prodhimin bujqësor dhe rritjen e bagëtive. Bujqësia është burimi kryesor i të ardhurave dhe eksportit, me prodhimet si kafeja, pambuku, çaji, perimet dhe produktet blegtorale si qumështi dhe mishi i pulave. Shumica e fermave në vend janë të vogla dhe përdorin teknologji të thjeshtë, ndërsa një pjesë e konsiderueshme e tokës zotërohet nga gratë.

Sektori i pylltarisë dhe peshkimit ka potencial të madh. Uganda gjithashtu ka rezerva minerale si ari, bakri, kobalti dhe kolumbite-tantalite; në vitet 2000



ka filluar edhe prodhimi i naftës.

Pjesa më e madhe e energjisë në vend sigurohet nga hidrocentralet e ndërtuara mbi lumin Viktoria (Nili), megjithatë, mungesa e energjisë ka bërë të nevojshme importin e saj nga Kenia. Energjia e përfituar nga drutë e zjarrit dhe qymyri i drurit përdoret gjithashtu në Uganda.

Industria kontribuon pak në GDP-në e vendit, dhe është e fokusuar kryesisht në përpunimin e produkteve bujqësore, prodhimin e çimentos, tekstileve, produkteve metalike, etj.

Zhvillimi ekonomik ka hasur vështirësi për shkak të paqëndrueshmërisë politike, por që nga vitet 1990 ekonomia ka njohur stabilitet dhe rritje, duke përfituar nga investimet e huaja, nga privatizimi, reformat monetare dhe lehtësimet e borxhit.

HISTORI

Disa data kyçe në historinë e Ugandës:

Vitet 1000 p.e.s. – Bujq, folës të gjuhëve Bantu, vijnë në jug të Ugandës, ndërkohë që folësit e gjuhëve Nilotike vendosen në verilindje.

Rreth viteve 1000 p.e.s.–500 e.j. – Perandoria Kitara kontrollon rajonin e liqeneve të mëdha të Afrikës Lindore. Në kulmin e saj, kjo perandori, e njohur edhe si 'Perandoria e Diellit' ose 'e Hënës', sundon pjesë të mëdha të luginës së Nilit.

Shekulli i 13-të – Buganda bashkohet nën mbretin e saj të parë Kato Kintu, themeluesi i dinastisë 'Kintu e Bugandës'.

Shekujt 18-19 – Buganda dhe rivalja e saj Bunyoro, bëhen mbretëritë më të fuqishme në rajon.

Në vitet 1830 – Tregtarë arabë

muslimanë hyjnë në rajon përmes Oqeanit Indian.

V.1869 – Khedive Ismail Pasha i Egjiptit kërkon të aneksojë tokat në veri të liqenit Viktoria dhe dërgon eksploruesin britanik Samuel Baker në një ekspeditë ushtarake; Bakeri mundet nga mbretëria Banyoro.

V.1886 – Seria e luftërave fetare në Buganda, fillimisht mes muslimanëve dhe të krishterëve, pastaj nga vitet 1890 mes protestantëve dhe katolikëve, e përçan popullsinë.

V.1894 – Britanikët aneksojnë Bugandën dhe territoret fqinje, dhe krijojnë 'Protectoratin e Ugandës', me qëllimin për të mbrojtur rrugën tregtare të lumit Nil.

Vitet 1890 – Punëtorë nga India britanike sillen në Afrikën Lindore, fillimisht për të ndërtuar hekurudhën e Ugandës.

V.1962 – Pavarësia: Kushtetutë federale, me Muteesa - Mbretin e Bugandës - si president, dhe Milton Obote si kryeministër.

V.1963 – Uganda bëhet republikë.

Vitet 1962–66 – Kriza e Bugandës: vitet e pas-pavarësisë dominohen nga lufta për pushtet mes qeverisë qendrore dhe mbretërisë më të madhe rajonale – asaj të Bugandës.


V.1967 – Milton Obote merr pushtetin me grusht shteti dhe shfuqizon mbretëritë fisnore.

Vitet 1971–79 – Gjenerali Idi Amin merr pushtetin.

V.1972 – Amin dëbon mijëra aziatikë ugandezë.

Vitet 1978–79 – Uganda sulmon Tanzaninë, por Tanzania kundërpërgjigjet, duke detyruar Amin të largohet nga vendi.

XHAMIA KOMBËTARE E UGANDËS, KAMPALA E VJETËR



V. 1980 – Milton Obote kthehet në pushtet.

Vitet 1980–86 – Zhvillohet 'Lufta Ugandeze e shkurreve' mes qeverisë Obote dhe grupeve kryengritëse, kryesisht 'Ushtrisë Kombëtare të Rezistencës (NRA)', luftë nga e cila rezultuan rreth 500,000 të vrarë.

V.1986 – Lideri i kryengritësve Yoweri Museveni merr pushtetin, dhe fillon një periudhë stabiliteti.

V.2005 – Referendumi mbështet politikën me shumë parti, por heq kufizimet për mandatin presidencial, duke lejuar presidentin Museveni të garojë për një mandat të tretë.

SI ERDHI ISLAMI NË UGANDË

Islami, si feja e parë e ardhur nga jashtë, mbërriti në Ugandë nga veriu, në agim të shekullit të 18-të, dhe u përhap përmes rrjeteve të brendshme të tregtisë bregdetare të Afrikës Lindore deri në mesin e shekullit të nëntëmbëdhjetë. Islami për herë të parë u predikua gjatë kohës së Mbretërisë Buganda - në vitin 1844 - gjatë mbretërimit të Kabaka Sūna i 2-të. Mësimet e Islamit u predikuan nga arabët dhe suahili-tët, të ardhur nga Zanzibari, në Bregun Lindor të Afrikës. Megjithatë, ndërsa Kabaka Sūna i lejoi predikuesit arabë/suahili të jepnin mësim rreth Islamit në oborrin e tij, ai vetë nuk u konvertua në Islam dhe as nuk e inkurajoi atë të mësohej jashtë oborrit të tij. Megjithatë, thuhet se ai ka mësuar pjesë nga Kur'ani.

Djali dhe pasardhësi i Sūna-s, Kabaka Muteesa i Parë, tregoi më shumë interes për fenë Islame. Mësimet Islame e tërhoqën shumë atë, kështu që u bë musliman. Ai mësoi gjuhën arabe dhe zotëroi Kuranin. Ai gjithashtu i udhëzoi krerët dhe të afërmit e tij ta studionin Kur'anin; pallati i tij në Banda - në

periferi të Kampalës - u bë Qendër e Arsimimit Islam.

Kur misionarët e krishterë mbërritën në Uganda, në vitin 1877, ata sfiduan monopolin e Islamit duke i mësuar Muteesa-s një fe alternative botërore. Atmosfera fetare filloi të ndryshonte ngadalë dhe vazhdoi të ndryshonte derisa të krishterët fituan epërsi. Të krishterët fituan të konvertuar dhe gjithashtu u mësuan atyre aftësi të përgjithshme që do të rezultonin jetësore më vonë në menaxhimin e shoqërisë. Ata gjithashtu u dhanë ndihmë ushtarake të konvertuarve të tyre dhe kështu e kthyen pushtetin kundër muslimanëve. Megjithatë, ironikisht, ishte disfata ushtarake që pësuan muslimanët ajo që e rriti përhapjen e Islamit në pjesë të tjera të vendit. Muslimanët që u arratisën në pjesë të ndryshme të vendit filluan t'u mësonin Islamin banorëve të vendeve ku shkonin dhe të ftonin të konvertuar.

Ardhja e Islamit në Ugandën veriore ndodhi pothuajse në të njëjtën kohë me atë në Bugandë. Tregtarët egjiptianë të fildishit që u zhvendosën nëpër Sudan pas vdekjes së Muhamed Aliut (udhëheqës i Egjiptit në fillim të shekullit të 19-të) në vitin 1849, arritën aq larg në jug sa që erdhën deri në Acholi, Lango, Bunyoro dhe Nilin Perëndimor (në Ugandën veriore dhe veriperëndimore. Ndërsa vazhduan me aktivitetet e tyre tregtare, ata gjithashtu konvertuan një numër të popullsisë vendase në Islam. Po ashtu, rreth kësaj kohe ushtarët nubianë (sudanezë) nën komandën e Emin Pashës, u vendosën në Ugandën veriore. Në vitin 1884, Muhamed Ahmed Mehdiu mori kontrollin e Sudanit Verior dhe ua preu rrugën Emin Pashës dhe ushtarëve të tij të ktheheshin në Sudan. Shumica dërmuese e ushtarëve u vendosën në zonë dhe u përzier me

popullsinë vendase. Edhe pse Pasha ishte i krishterë, ushtarët e tij ishin muslimanë dhe ata përbëjnë kryesisht prejardhjen e muslimanëve në rajonin e Nilit Perëndimor sot.

Pas kryengritjes sudaneze të viteve 1890, shumë ushtarë muslimanë sudanezë kaluan në atë që sot quhet Uganda. Ata u zhvendosën nëpër zonën Acholi-Lango dhe u vendosën në mesin e grupeve etnike Madi, Lugbara dhe Kakwa, dhe shumë prej banorëve vendas i konvertuan në Islam. Disa nga këta ushtarë u sollën më vonë në Buganda për të ndihmuar të krishterët dhe qeverinë koloniale për të luftuar muslimanët gjatë luftërave ndërfitare të fillimit të viteve 1890. Kur këta e kuptuan se ishin sjellë për të luftuar bashkëmuslimanët e tyre, ata refuzuan të luftonin dhe u vendosën në zonën e Bombos (20 milje në veriperëndim të Kampalës). Sot, zona e Bombos është një nga pjesët më të islamizuara të Bugandës. Më vonë, pas disfatës së tyre në luftërat fetare, shumë muslimanë u vendosën në qarkun e Butambalas (30 milje në jug të Kampalës). Islami vazhdoi të përhapej ngadalë në pjesë të ndryshme të vendit si nga Buganda ashtu edhe nga veriu. Komuniteti musliman në Ugandë, i cili është i përhapur në të gjithë vendin, është rezultat i këtij procesi të shkëputur. (Ref. Islami në Ugandë, nga Dr. Abasi Kiyimba).

Përgatiti:

Msc. Arta Ujkaj, teologe

<https://en.wikipedia.org>
<https://www.britannica.com>
<https://www.bbc.com>
<https://ugandaislamicmuseumandresearchcentre.org>
<https://2021-2025.state.gov>
<https://www.worldometers.info>
<https://www.bbc.com>



H. Halil Avdulli

Vushtri - Kosovë

Është shqetësues dhe tronditës fakti se botën nuk e udhëheqin vetëm idetë dhe mendjet, siç besojnë shumica e njerëzve, në realitet, motivet dhe ndjenjat patologjike janë thelbi që ka formuar shumicën e qytetërimeve, ka shpikur shumicën ideologjive që i njeht njerëzimi deri me sot, pa i përjashtuar edhe ato që udhëheqin botën sot.

Në fakt, shumica e krimeve, mëkateve të kryera dhe luftërave që kanë ndodhur gjatë historisë kanë qenë të lidhura apo të motivuara në një mënyrë apo një tjetër, nga përzjerjet emocionale të sëmura njerëzore që është vështirë për t'i kuptuar, për sa kohë që ato janë aq qesharake dhe shumë të ulëta.

Kjo ndodh ngase gjendja psikologjike e njerëzimit si një tërësi nuk është shumë e ndryshme nga gjendja psikologjike e një individi normal, që shpesh kalon nëpër situata të arrogancës dhe

ILUZIONI SE MENDJA UDHËHEQ BOTËN

kotësisë, të depresionit e braktisjes, që zakonisht manifestohen në formë të ideve të sëmura që kanë rezultuar me pasoja katastrofike për botën.

Këto ide për të patur sukses në tërheqjen e njerëzve rreth tyre, mbulohen me petkun e mendjes dhe logjikës sa për t'u arsyetuar më mirë, ani pse ato nuk janë gjë tjetër vetëm manifestim i ndjenjave dhe inateve të fshehura patologjike.

Njeriu i malit me gjithë injorancën dhe mungesën e qytetërimit që kishte, solli me shumë moral dhe lumturi, me më pak filozofi dhe teori. Kurse sot, me gjithë shpikjet, filozofitë dhe qytetërimet që janë arritur, nuk mund të kemi as një të katërtën e qetësisë dhe lumturisë që kishin paraardhësit tanë.

Sekularizmi, për shembull, mund të tregtohet si një ide e studiuar dhe prodhuar nga mendjet e ndërgjegjshme, por nëse e shohim në kontekstin e tij historik na çon në mendje se ishte një reaksion emocional jo edhe aq vetëdijshëm, përballë pushtetit arbitrar të Kishës, dhe nuk është se ishte një ide racionale e menduar mirë, por me vete bartë shumë ngarkesa emocionale dhe historike që nuk mund të injorohen në asnjë mënyrë.

Kolonializmi evropian që skllavëroi popuj dhe toka, e ofroj veten si një valë e re kulturore që kërkon të sjellë modernizmin dhe zhvillimin e shoqërive të botës se pazhvilluar, edhe pse ajo,

në fakt, erdhi si rezultat i një ndjenje tjetër psikologjike që mund ta ketë origjinën në periudhën e zbulimeve të mëdha shkencore dhe revolucionit industrial që kanë ndodhur në Evropë, e që për rezultat kanë lindur një njeri evropian, i cili të tjerët i sheh me epërsi dhe përbuzje... deri në atë masë sa t'ia lejoj vetës grabitjen e lirisë së tjetrit dhe t'ia imponojë atij gjitha format e hegjemonisë intelektuale nën pretekstin se është injorant dhe i prapambetur.

Po ta shohim luftën e parë dhe të dytë botërore, që të dyja ishin manifestim i iluzioneve dhe çmendurive psikologjike të udhëheqësve botëror të asaj kohe. Për më tepër, humbësit më të mëdhenj në këto luftëra ishin idetë nacionaliste në çdo kuptim, madje edhe ata që nuk hynë në luftë dhe nuk ishin pjesë e aleancave nuk u kursyen nga shkatërrimi.

Këto luftëra përfunduan me pasoja të mëdha për njerëzimin, sepse ato duket se pushuan në të jashtmen e tyre por jo edhe në brendësinë e qenieve njerëzore të manifestuara më egoizëm dhe me ndjenjën e të shpëtuarit individual, e për sa i përket botës ajo le të shkoj në ferr.

Unë nuk e di, por mua më duket se çdo moment që po kalojmë në këtë planet rritet mjerueshmëria, çorientimi intelektual dhe devijimi moral.

(www.mesazhi.com)



MYFTIU I SHKODRËS VIZITOI BASHKËSINË ISLAME SHQIPTARE NË DANIMARKË

Me ftesë zyrtare të Bashkësisë Islame Shqiptare në Danimarkë, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, mori pjesë në disa prej aktiviteteve të saj të larmishme përgjatë periudhës 8-11 janar 2026.

Gjatë kësaj vizite të parë në Kopenhagë, Myftiu Sytari u takua me Kryetarin e Bashkësisë Islame Shqiptare në Danimarkë, H. Basri Kurtishi, prej të cilit mësoi për historikun e organizmit të muslimanëve shqiptarë në Danimarkë



dhe aktivitetin e xhamisë në vendet skandinave.

Ditën e xhuma, më 9 janar 2026, Myftiu i Shkodrës mbajti hytben e xhumasë në xhaminë e shqiptarëve në Kopenhagë, ku u drejtua të pranishmëve me disa mesazhe që lidhen me edukimin e brezit të ri me vlerat e udhëzimit dhe dinjitetin e të dëshmuarit si mëkëmbës i Allahut në tokë.

Ndërkohë, ditën e shtunë, më 10 janar 2026, Myftiu Sytari ligjëroi në ceremoninë e përfundimit të Hatmes së Kur'anit nga një grup i madh studentësh shqiptarë të kësaj xhamie, ku dha mesazhet e tij, të shoqëruara me

falënderimet dhe mirënjohjen e thellë për Kryetarin e Bashkësisë Islame Shqiptare në Danimarkë, H. Basri Kurtishi, falë përkushtimit të cilit, dëshmohej kjo arritje e madhe.

Gjatë qëndrimit në Danimarkë, Myftiu i Shkodrës u takua edhe me gazetarin e njohur të Radio "Projekt 21" në Kopenhagë, z. Luigj Shkodrani, të cilin e falënderoi për bashkëpunimet e kahershme dhe praninë e tij në xhaminë shqiptare në Kopenhagë, edhe si një dëshmi e harmonisë kombëtare dhe bashkëpunimit me vlerë në mesin e shqiptarëve në botë.

Myftiu vizitoi edhe Xhaminë Qendrore

Shqiptare në Kopenhagë, ku u mirëprit nga imami i nderuar, H. Ruzhdi Asipi, këshilli dhe besimtarët, me të cilët zhvilloi një bashkëbisedim vëllazëror.

Myftiu Sytari vizitoi edhe xhaminë e madhe të Malmoes në Suedi, që udhëhiqet nga imami i nderuar shqiptar, H. Roland Vishkurti.

Në përfundim të kësaj vizite të paharruar, Myftiu Imam Muhamed B. Sytari, shprehu mirënjohjen dhe falënderimet e tij për ftesën bujare të Bashkësisë Islame Shqiptare në Kopenhagë dhe u lut për suksese të vazhdueshme në rrugën e përhapjes së udhëzimit islam me urtësi e largpamësi.



"KËSHILLI I PAJTIMTARËVE", PROJEKTI MË I RI I MYFTINISË SHKODËR



Ditën e mërkurë, më 14 janar 2026, u zhvillua mbledhja e radhës e imamëve të Myftinisë Shkodër.

Gjatë fjalës së tij, përpara imamëve të pranishëm, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, shpjegoi kuptimet e ajetit të 10-të të sures El-Huxhurat, ku Allahu i Madhëruar urdhëron dhe thotë: "Me të vërtetë, besimtarët janë vëllazër; dhe, pajtoni mes vëllazërve tuaj. E, kijeni frikë Allahut, që të mëshiroheni!"

Në shpjegimin e tij të këtij ajeti, Myftiu i Shkodrës u ndal tek një pikë që e konsideroi me shumë rëndësi për çdo musliman dhe në veçanti për misionin e imamëve të Myftinisë Shkodër.

Ndër të tjera theksoi: "Të dashur dhe të nderuar vëllazërit e mi, ajeti kur'anor që sapo lexova përpara jush është një ftesë e rëndësishme për të ruajtur ekuilibrat e vëllazërisë në mesin tonë. Prandaj, e kemi për detyrë të ndjekim njëri-tjetrin dhe mos të lejojmë që shejtani të prishë ekuilibrat e vëllazërisë

në mesin tonë. Udhëzoj që në çdo xhami të ngrihet "Këshilli i pajtimtarëve".

Ky projekt i ri i Myftinisë tonë ka për qëllim që të krijojë një ambient përherë e më të ngrohtë dhe vëllazëror në çdo xhami prej xhamive tona, dhe të përpiqemi bashkërisht që të ruajmë ekuilibrat e harmonisë dhe vëllazërisë në mesin tonë, sepse vëllazëria islame qëndron mbi çdo lidhje tjetër në këtë botë dhe detyra e jonë është që ta mbrojmë këtë vëllazëri të shenjtë, ta zhvillojmë atë dhe ta çojmë përpara duke zhvilluar komunitetin dhe bashkësinë tonë."

Në fund të këtij takimi teologu Lavdrim Hamja dha disa shpjegime me rëndësi që kanë të bëjnë me risinë e re të disiplinimit të ceremonive të kurorëzimit sipas udhëzimit të Kryetarit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

U dhanë udhëzime edhe për aktivitetet e ndryshme që do të zhvillojë Myftinia Shkodër në prag të muajit të madhnueshëm të Ramazanit.



MYFTIU I SHKODRËS LIGJËROI NË AKTIVITETIN E B.I. ULQIN, NË PRAG TË RAMAZANIT



Me ftesë të Mexhlsit të Bashkësisë Islame në Ulqin të Malit të Zi, mbrëmjen e së dielës, më 18 janar 2026, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari mori pjesë në Tribunën Fetare, që u zhvillua në xhaminë e madhe të Pinjeshit, në prag të muajit të madhërishtëm të Ramazanit.

Në këtë mbrëmje fetare plot mirësi dhe bekim ishte planifikuar që ligjërues nderi të ishte Dr. Ferid Piku (Drejtor i Qendrës Minber), si dhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari.



Pas faljes së namazit të jaciesë, nën drejtimin e Myftiut të Shkodrës, aktiviteti nisi me fjalën e rastit nga kryeimami i Ulqinit, Mr. Ali ef. Bardhi, i cili pasi uroi mirëseardhjen dy të ftuarve të nderuar, si dhe besimtarëve të shumtë të pranishëm në xhami, theksoi se tubime të tilla janë një mundësi e mirë për të ngrohur zemrat e besimtarëve në prag të muajit të begatë të Ramazanit.

Ndërkohë, dy ligjëruesit e nderuar dhanë mesazhe të rëndësishme që kanë të bëjnë me përsosjen e adhurimit dhe përgatitjen e duhur me rastin e ardhjes së muajit të begatë të Ramazanit. U vu theksi te fakti, se muaji i madhërishtëm i Ramazanit ka një ndikim jashtëzakonisht të madh në përmirësimin e gjendjes emocionale, psikologjike dhe shpirtërore të besimtarëve muslimane.

Muaji i madhërishtëm i Ramazanit është në shkollë e madhe adhurimi dhe një përmirësues çudibërës i jetës së gjithësecilit prej nesh.

DR. ZEKERIJA BAJRAMI, KËSHILLA DHE MESAZHE TË URTA NË PRAG TË RAMAZANIT

Ditën e shtunë, më 17 janar 2026, Myftinia Shkodër nisin ciklin e ri të ligjëratave me mesazhe dhe këshilla në prag të muajit të madhnueshëm të Ramazanit 1447.

I ftuar nderi i kësaj dite ishte Hoxha i dashur nga Shkupi, Dr. Zekerija Bajrami.

Në krye të herës ai zhvilloi një vizitë në Myftininë e Shkodrës, ku u prit nga Myftiu, Imam Muhamed B. Sytari, i cili i uroi mirëseardhjen dhe shprehu kënaqësinë e tij për praninë e Hoxhës së nderuar në mesin e besimtarëve muslimanë të Shkodrës.



Gjatë këtij takimi të përzemërt u diskutua edhe për domosdoshmërinë e zhvillimit të aktiviteteve të larmishme që mbajnë gjallë veprimtaritë fetare në mesin e besimtarëve.

Më pas, në xhaminë e Parrucës, ku prezantonin shumë besimtarë të interesuar për ligjëratën e kësaj dite, pas namazit të mesditës nisi aktiviteti i shumëpritur.

Në fjalën e tij të rastit, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, shprehu kënaqësinë e pranisë së Hoxhës së nderuar, Dr. Zekerija Bajrami në mesin e besimtarëve muslimanë të Shkodrës dhe e krahasoi aktivitetin e sotëm me lulet e para të mimosës që sinjalizojnë ardhjen e pranverës.

Me shumë kënaqësi të pranishmit dëgjuan ligjëratën plot mesazhe dhe këshilla të dobishme nëpërmjet të cilave Dr. Zekerija Bajrami iu drejtua besimtarëve duke hedhur dritë rreth ajetit: “O ju të cilët keni besuar, përgjigjuni Allahut dhe të Dërguarit kur ju thërret në atë që ju jep jetë!” – (Kur’ani, El-Enfal: 24)

Nëpërmjet shembujve të shumtë nga hadithet e Pejgamberit (a.s), jeta e sahabëve dhe përvoja personale, ai hodhi dritë mbi disa prej mënyrave nëpërmjet të cilave muslimanët mund të përmirësojnë cilësinë e adhurimit dhe dëshimit të tyre si besimtarë në përditshmërinë e tyre.

Ligjëruesi i dashur nga Shkupi uroi

besimtarët me rastin e Tre Muajve të Mirë dhe u lut për mirëqenien e tyre, për të sëmuret, për njerëzit në nevojë, e në veçanti për banorët e Gazës, që jetojnë momente të vështira në realitetet e zymta si pasojë e zullumeve të shumta dhe luftërave të padrejta.

Ky cikël ligjëratash me të ftuar nderi do të vijojë edhe në javën në vijim, ku Myftinia Shkodër ka përgatitur një sërë aktivitete të larmishme për gjallërimin e jetës fetare në prag të muajit të madhnueshëm të Ramazanit.

Aktiviteti i ditës së sotme u ndoq nga mediat lokale të qytetit të Shkodrës, të cilat i bënë jehonë në edicionet e ndryshme informative të ditës.



“SAKRIFICAT E DIJETARËVE TË HADITHIT NDËR SHEKUJ”, LIGJËRATA ME DOBI NË XHAMINË E PARRUCËS



Në vazhden e ciklit të aktiviteteve me këshilla dhe mesazhe në atmosferën e begatët të Tre Muajve të Mirë, ditën e xhuma, më 23 janar 2026, pas namazit të akshamit në xhaminë e Parrucës, Myftinia Shkodër organizoi tribunën fetare të radhës.

I ftuar nderi ishte ligjëruesi, H. Dritan Rrahmani, imam në xhaminë Arrameras, Fushë-Krujë.

Aktiviteti u hap me fjalën e rastin nga teologu Ervil Kuçi, i cili falënderoi të pranishmit dhe imamin e nderuar për pranimin e ftesë nga Myftinia Shkodër për të ligjësuar në këtë cikël të dobishëm me ligjëratat të ndryshme në dobi të besimtarëve.

Më pas aktiviteti u përshëndet nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili vuri theksin tek rëndësia që kanë tubimet në të cilat muslimanët mbledhen për të mësuar dhe për t'u thelluar në dije, për të shtuar besimin dhe vlerat e harmonisë në mes vete.

Aktiviteti vijoi me ligjëratën e mbajtur nga H. Dritan Rrahmani, i cili ligjëroi rreth një teme shumë interesante që na merr për dore drejt vlerësimit të dijetarëve të hershëm dhe aktual të botës

islame, të cilët janë përkushtuar përgjatë shekujve për ruajtjen dhe transmetimin me shumë fanatizëm dhe përkushtim të fjalëve të Dërguarit të Allahut, Hz. Muhamedit (a.s).

Në ligjëratën e tij, hoxha i nderuar solli shembuj nga jeta e të parëve, nga sahabët e Pejgamberit (a.s) tek korifenjtë e jurisprudencës islame dhe shkencës së hadithit, në shembullin e të cilëve gjejmë një përkushtim të jashtëzakonshëm, në kufijtë e të paimagjinueshmes, për të ruajtur dhe transmetuar me përpikmëri fjalët dhe udhëzimet e Hz. Muhamedit (a.s).

Me përfundimin e ligjëratës, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari falënderoi hoxhën e nderuar për mesazhet plot dobi dhe solli në vëmendje disa këshilla dhe mesazhe nga dijetari i madh shqiptar, Hoxha i jonë, H. Vehbi Sulejman Gavoçi, i cili ishte një njeri i madh i përkushtuar ndaj dijes dhe gjurmëve të të parëve, si dhe një kujdestar fisnik i studentëve të dijes islame, veçanërisht nga qyteti i Shkodrës.

Cikli i ligjëratave në atmosferën e prag Ramazanit do të vijojë edhe përgjatë javëve të ardhshme.



“TË MËSOJMË DHE TË ARGËTOHEMI”, AKTIVITET SPORTIV-EDUKATIV PËR NXËNËSIT E MEJTEPEVE BAHÇALLËK DHE AJASËM



Paradrecen e të shtunës, më 24 janar 2026, sektori i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër, zhvilloi një aktivitet sportiv-edukativ mes nxënësve të mejtepeve/kurseve fetare të xhamive Bahçallëk dhe Ajasëm, me synimin për të nxitur frymën e vëllazërisë dhe zhvillimit të shëndetshëm fizik e shpirtëror tek të rinjtë.



Ky aktivitet me moton: “Të mësojmë dhe të argëtohem” u përshëndet nga drejtuesi i arsimit në Myftininë Shkodër, teologu Arben Halluni, i cili falënderoi nxënësit për pjesëmarrjen e tyre aktive dhe përkushtimin e treguar në këtë veprimtari sportive. Ai theksoi se ky aktivitet ka për qëllim jo vetëm vlerën edukative, por edhe atë argëtuese e zbavitëse, duke e bërë mësimin më të dashur dhe më të afërt për nxënësit.

Teologu Halluni falënderoi edhe imamët dhe mësuesit e dy xhamive, Bahçallëk dhe Ajasëm, H. Ademir Xama dhe H. Agron Kastrati, për angazhimin dhe kontributin e tyre të vyer në organizimin dhe zhvillimin e përbashkët të kësaj veprimtarie edukative dhe argëtuese.

Më pas, fëmijët të ndarë në grupe zhvilluan disa ndeshje futbolli në formatin mini-futboll, duke krijuar një atmosferë sportive, dinamike dhe plot entuziazëm e kënaqësi.

40 UMREXHI SHKODRANË NISEN DREJT VENDEVE TË SHENJTA

Ditën e shtunë, më 24 janar 2026, pas namazit të iqindisë, në xhaminë e Parrucës, Myftinia Shkodër në bashkëpunim me Agjencinë “Umre Medina Travel Albania” organizoi aktivitetin e përcjelljes së 40 umrexhëve shkodranë, të cilët do të nisen drejt Vendeve të Shenjta, ditën e diel, më 25 janar 2026.

Aktivitetin e hapi teologu Ensar Ismailaj, i cili foli për rëndësinë dhe përgjegjësinë që ka organizimi i Haxhit dhe i Umres, si dhe përvojat e studentëve shqiptarë të Universitetit të Medinës, të cilët gjithmonë janë angazhuar në shërbim të haxhilerëve dhe umrexhëve.

Më pas, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, në fjalën e tij u shpreh se është mirësi e madhe nga Allahu i Madhëruar përzgjedhja e besimtarëve muslimanë të Shkodrës përgjatë shekujve për të vizituar Vendet e Shenjta dhe për të qenë prej haxhilerëve dhe umrexhëve.

Myftiu theksoi se shtimi i numrit të haxhilerëve dhe umrexhëve shqiptarë, vit pas viti, është dëshmi e madhe e besimit dhe e rritjes së dëshirës së rinisë në veçanti për ta dëshmuar identitetin



e tyre islam edhe nëpërmjet kryerjes së këtij adhurimi.

Gjithashtu, në fjalën e tij, Myftiu Sytari nxiti për të shtuar vizitat e Vendeve të Shenjta, duke treguar për hadithin e Pejgamberit (a.s.), i cili ka thënë: “Vazhdoni dhe kryeni Haxhin dhe Umren, sepse ato të dyja zhdukin varfërinë dhe gjynahet, ashtu si zjarri zhduk papastërtitë e hekurit, arit e argjendit!”

Pastaj, fjalën e mori H. Gilman Kazazi, në pozitën e drejtuesit të këtij grupi të umrexhëve. Ai u ndal tek rëndësia dhe

rregullat e kryerjes së Umres, sikurse dha këshilla dhe porosi të dobishme për të pranishmit që udhëtojnë drejt Vendeve të Shenjta.

Ai iu drejtua besimtarëve që të jenë të vëmendshëm gjatë momenteve të kryerjes së Umres në mënyrë që ritualët e këtij adhurimi madhështor të jenë sa më të plotë dhe ky udhëtim të ketë suksesin dhe pranimin nga ana e Zotit të gjithësisë.

Në fund të aktivitetit u shpërndanë edhe ihramet për grupi e umrexhëve.

“NGA ZEMRA NË VEPËR, SI TA JETOJMË BESIMIN ME VLERA” – LIGJËRATA E TEOLOGES AIDA SHEGA PËR MOTRAT BESIMTARE

Në kuadër të aktiviteteve të larmishme, në atmosferën e prag Ramazanit 1447, Myftinia Shkodër zhvilloi ditën e shtunë, më 24 janar 2026, në xhaminë e Parrucës, tribunën fetare për motrat myslimane me titull: “Nga zemra në vepër, si ta jetojmë besimin me vlera”, me të ftuar teologen znj. Aida Shega.

Aktiviteti në fjalë, që ishte kushtuar veçanërisht motrave besimtare u fokusua tek rëndësia e dëshimit të besimit në jetën e përditshme, duke kaluar prapë e zemrës dhe pretendimeve që njeriu ka në përditshmërinë e tij në realitetin e të dëshmuarit në përditshmëri dhe në marrëdhënie konkrete në mesin e njerëzve.

Programi u hap me lexim Kurani nga nxënësja Erisa Ethemi, e cila solli një fillim të bukur dhe të bekuar për këtë tribunë fetare.

Në ligjëratën e saj, teologjia e nderuar, znj. Aida Shega përcolli mesazhe të



vlefshme mbi rëndësinë e përgatitjes shpirtërore për muajt Rexheb, Shaban dhe Ramazan, duke theksuar rolin e gruas myslimane në forcimin e besimit dhe vlerave familjare e shoqërore.

Pas ligjëratës, programi vijoi me pjesë artistike e reflektuese nga nxënëset: Eralda Mehja, nxënëse e Qendrës Kulturore Oblikë, e cila interpretoi një poezi për Ramazanin, të shkruar nga vetë ajo dhe që u prit me shumë ngrohtësi

nga të pranishmet. Ndërsa Erisa Fangaj, nxënëse e Qendrës Kulturore Bardhaj, lexoi një monolog për Tre Muajt e Mirë, duke përcjellë emocion dhe mesazhe shpirtërore.

Aktiviteti u moderua nga znj. Kimete Elezi, e cila udhëhoqi mbarëvajtjen e programit, duke krijuar një atmosferë shpirtërore dhe reflektuese për motrat besimtare të pranishme.

“BESONI TEK E MIRA QË BËNI!”, MESAZHE ME VLERË NGA H. TAHIR ZENELHASANI

Ditën e shtunë, më 31 janar 2026, Myftinia Shkodër zhvilloi tribunën fetare të radhës në atmosferën e Tre Muajve të Mirë, ku i ftuar nderi ishte edukatori i dashur dhe intelektual i shquar, H. Tahir Zenelhasani.

Aktiviteti i u përshëndet nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari dhe nga Myftiu i Malësisë së Madhe, H. Edmir Smajlaj, të cilët dhanë mesazhet e rastit duke tërhequr vëmendjen drejt rëndësisë së dijes dhe vlerave të saj si shpëtim për njeriun në realitetet e ndryshme të jetës së tij.



Me shumë vëmendje të pranishmit ndoqën ligjëratën e të nderuarit H. Tahir Zenelhasani, i cili shprehu kënaqësinë e tij për këtë ftesë bujare të Myftinisë Shkodër, një qytet për të cilin ai shprehu respektin dhe nderimin e madh për historinë e pasur të këtij qyteti të dijes dhe të dijetarëve ndër shekuj.

Në ligjëratën e tij, i nderuari H. H. Tahir Zenelhasani foli për majat e adhurimit që konsiston në mendimin e mirë për Zotin në jetë, sikurse tërhoqi vëmendjen e të pranishmëve që njëkohësisht si kulm i adhurimit në jetën e përditshme duhet të jetë mendimi i mirë për njëri-tjetrin për

të ruajtur komunikimin plot dinjitet dhe harmoni si mëkëmbës të Zotit në jetë.

Ligjëruesi i nderuar theksoi se ne si besimtarë kemi privilegjin e madh të jetojmë dhe të punojmë për hatër të Zotit duke ndërtuar të mirën, duke e jetuar atë në përditshmëri dhe duke e përhapur me tjetrin kushdo qoftë ai. Ai theksoi se ne nuk duhet të mendojmë për fidanin e fundit, por të mbjellim çdo ditë nga një fidan të së mirës për ta zbuluar jetën dhe për ta mbushur atë me bekimet dhe pëlqimet e Zotit Fuqiplotë.

Në ligjëratë e kësaj dite u vu theksi njëkohësisht edhe tek realiteti i banorëve

të Gazës, të cilët prej vitesh përballen me një zullum të pashembullt, por që në vetvete me këmbënguljen, besimin dhe dinjitetin e tyre u kthyen në një shembull për rizgjimim e vetëdijes së mbarë njerëzimit drejt faktit se njeriu me besim dhe në të drejtën me këmbëngulje dhe larg pesimizmit mund të kthehet në një mrekulli që fton drejt rimëkëmbjes së vlerave për mbarë njerëzimin.

Ligjëruesi i nderuar theksoi se njeriu është krijesë e ftuar drejt moralit, virtutit dhe zhvillimit dhe se Zoti i gjithësisë e krijoi të aftë që të jetë mëkëmbësi i Tij në tokë. Prandaj, sikurse edhe theksoi ftesa e besimit për gjithësecilin prej nesh sot është të rikthehemi tek origjina e jonë për të përmirësuar realitetet e përditshme që jo pak janë prishur.

Aktiviteti u mbyll nga teologu Lavdrim Hamja, i cili pasi falënderoi mikun e shtrenjtë për ligjëratën cilësore dhe mesazhet plot vlera të saj lajmëroi të pranishmit se aktivitetet e Myftinisë Shkodër në prag të muajit të madhërisëm të Ramazanit do të vijojnë me ligjëratën e radhës të shtunë e ardhshme, më 7 shkurt 2026, pas namazit të mesditës në xhaminë e Parrucës.



بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ



Myftinia Shkodër

**DITËT DHE NETËT E SHËNUARA ISLAME
PËR VITIN 2026
(1447-1448 HIXHRI)**



- 15.01.2026 Nata e Mirë e dytë - Isra dhe Miraxh
02.02.2026 Nata e Mirë e tretë - Beraet
19.02.2026 Dita e parë e agjërimit të Ramazanit
16.03.2026 Nata e Kadrit
20.03.2026 Dita e parë e Fitër Bajramit
26.05.2026 Dita e Arafatit
27.05.2026 Dita e parë e Kurban Bajramit
16.06.2026 Dita e parë e Vitit të Ri Hixhri 1448
25.06.2026 Dita e Ashurasë
24.08.2026 Ditëlindja e Profetit Muhammed (a.s)
(Mevludi Sherifë)

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org